



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 105, datë 18.07.2018

PËR
MIRATIMIN E ZJ. ANILA HOXHA NË POZICIONIN E DREJTORIT EKZEKUTIV TË
BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 43, paragrafi 2, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe nenit 21, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Zj. Anila Hoxha në pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv të Byrosë Shqiptare të Sigurimit për një afat 6 (gjashtë) mujor, me të drejtë riemërimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Klodion SHEHU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI